

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDESHME

Ekzemplar Nr. 2

DEGA E PUNËVE TË BRENDESHME

Sektori i Sigurimit

Rrëshen më 5.11.1985

Nr. 1205L e n d a : Mbi një leter për repartin 303 Spaç

MINISTRISË PUNËVE TË BRENDESHME

DREJTORISË SË PARË

T I R A N Ë

E pam t' aesyeshme t'ju dërgojm përmbajtjen e një letre në adres të Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Mirditë, dërguar nga një L [] K [] nga Austria, (pa datë, por me vulë datore 21.10.1985), me këte përmbajtje, në anglisht :

Kryetarit Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Krahinorë Popullorë
Rrëshen- rrethi Mirditë Albania

L [] K []

Wetzelsdorf 67, 8330 Feldbach
Austria

I dashur zotni:

Kam lexuar së fundi raporte të frikshme përse i përket situates së jetes në burg në vendin tuaj. U habita shumë nga raporte të tilla nga propoganda (radio, televizioni) ndërkombëtar, sepse kam një interes shumë të veçant për Shqipërin. Do të dëshëroja kështu që t'u kërkoja ju me mirsjellje, që të përmirsoni ose jepni fund keqtrajtimit të mëposhtëm të jeteses në kampin e punës Spaç Nr.303 respektivisht.

Së pari unë do të dëshëroja që t'u propozoja që duhet të merren masa për mbrojtjen e punëtorëve në minjerat në mënyrë të plotë.

Për më tepër është raportuar një mungesë proteinash, zarzavatesh dhe frutash.

Për së treti atje ka vetëm dy mjek të cilët e kanë burgosur vetveten dhe 10 krevate të sëmurësh gjendje për mijra të burgosur, gjë e cila e bën kujdesin shëndetësorë të pa mjaftueshem për shkak se infermjeria është shumë shumë e vogël.

Për të keqsuar akoma më tepër gjendjen të burgosur të ndërgjegjshëm, mbahen shpesh në qeli të vetmuara me përmasa 1m-1.5 m, që u redukton lëvizjet e këmbëve dhe që janë të ndaluar të takojn vizitorët ose janë të detyruar të bëjnë punë të vështirë shtesë.

Unë jam i bindur se vlersimi ndërkombëtar për vendin tuaj do të rritet duke përmirësuar vazhdimisht abuzimet ekzistuese të fuqisë politike

Shënim: Unë do të jem shumë i kënaqur të marr një përgjigje nga ana juaj.

I juaj sinqerisht

L [] K []

Zëvendës Kryetari i Komitetit Ekzekutiv na vuri në dijeni dhe bashkërisht informuam Komitetin e Partisë. Letren origjinale e përkthyen, e nisen për në Kryeministri.

Sqarëjm se : me të vërtetë në repartin 303 Spaç ka dy mjek të dënuar, që kryejn shërbimin e mjekimit në infirmjeri, janë 10 krevate në infirmjeri, 5 për të dënuar për krime kundër shtetit e 5 për ato ordine:

KRYETARI DEGËS PUNËVE TË BRENDESHME

Bajram Pelo